

VENDIM
Nr. 461, datë 30.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 270, DATË 2.5.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESEMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE
TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)”, miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 270, datë 2.5.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, data “22.9.2021” ndryshohet dhe bëhet “15.3.2022”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe